



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.5.2021, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Vasilika Hysi – kryetar i Rrjetit

Rendi i ditës:

1. Informim nga anëtarët e Rrjetit për ecurinë e zbatimit të Planit të Veprimit të SELP nga institucionet përkatëse;
2. Të ndryshme.

Marrin pjesë:

Evis Qaja – Përfaqësuese e Këshillit të Ministrave

Elona Hoxha - Drejtore e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë

Fatmir Shehu - Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Ministria përgjegjëse për Punët e Brendshme

Enerieta Tarelli – Drejtore e Drejtorisë së Programimit, Ministria e fushës së Turizmit

Eges Osmani- Ministria përgjegjëse për fushën e Tregtisë

Arlinda Gjata - Specialiste, Drejtorja e të Drejtës Ndërkombëtare, Ministria përgjegjëse për Punët e Jashtme

Erzen Tola - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Ministria përgjegjëse për Arsimin

Griselda Sula - Ministria përgjegjëse për Arsimin

Vildan Kaloshi – Këshilli i Lartë Gjyqësor

Drita Avdyli – Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve

Nejla Peka – Komisionere, Avokati i Popullit

Blerta Xhako - Drejtore e Drejtorisë Juridike, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe
Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Ardiana Hala - Drejtore e Drejtorisë Juridike, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ergys Qirici - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

Mariana Semini - Shkolla e Magjistraturës

Ama Kraja – Përfaqësuese e OSBE-së

Ermira Shkurti – Përfaqësuese e UNICEF-it

Eda Noçka - Qendra “Altri”

Anisa Metalla – Përfaqësuese e TLAS

Urim Bajrami - Autoriteti i Mediave Audiovizive

HAPET MBLEDHJA

Vasilika Hysi – Përshëndetje, të nderuar përfaqësues të institucioneve qendrore, vendore, të shoqërisë civile dhe të medias!

Sot, sikurse jeni informuar, zhvillohet takimi i parë i Rrjetit për këtë vit në kuadër të Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut.

Së pari, më lejoni të shpreh falënderimet dhe mirënjohjen për gjithë angazhimin tuaj dhe të institucioneve që ju përfaqësoni, por edhe për arsyen që gjetët kohën për të qenë të pranishëm, sidomos në këtë periudhë, e cila është disi e ngarkuar për të gjitha institucionet!

Sikurse jeni njoftuar edhe nga sekretariati i Rrjetit të Edukimit Ligjor të Publikut, të ngritur në Kuvendi i Shqipërisë në vazhdim të strategjisë së edukimit ligjor dhe planit të veprimit që e shoqëron atë, dua t'ju informoj si anëtarë të Rrjetit për veprimtarinë që ka zhvilluar Rrjeti për periudhën nga janari i këtij viti.

E para, në datën 23 shkurt të vitit 2021 është mbledhur komisioni drejtues i Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut dhe ka zhvilluar mbledhjen e radhës së tij në të cilën është prezantuar raporti i parë i progresit të zbatimit të strategjisë së edukimit ligjor të publikut. Sipas parashikimeve, në strategjinë e edukimit ligjor, që ka miratuar Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 47, të vitit 2019, Ministria e Drejtësisë në fillim të çdo viti i paraqet Komitetit Drejtues të Rrjetit për diskutim dhe për miratim raportprogresin e zbatimit të strategjisë së edukimit ligjor dhe planit të veprimit.

Ju e dini që vitin e kaluar ka pasur vonesa në miratimin e planit të veprimit dhe në veprimtarinë e një sërë institucioneve edhe për shkak të periudhës së pandemisë, por do ta vlerësoja si një sukses që institucionit, pavarësisht vështirësive që diktonte periudha edhe për shkak të tërmetit, por në mënyrë të veçantë nga pandemia dhe të punës *online* që kanë punuar një pjesë e mirë e institucioneve arritën të raportnin dhe Ministria e Drejtësisë brenda një periudhë të shkurtër të hartonte raportin e parë për progresin e zbatimit të strategjisë, ku përfshihen të gjitha aktivitetet të periudhës janar-dhjetor 2020.

Ky proces ka qenë një qenë një proces gjithëpërfshirës. Hartimi dhe konsultimi i të gjitha aktiviteteve ka ndikuar në cilësinë e raportit, megjithëse është hera e parë dhe raportohej sipas një

platforme apo një programi të veçantë, besoj që si raport i parë duhet vlerësuar dhe pa dyshim që ka nevojë edhe për përmirësime.

Në fund të diskutimit në mbledhjen e muajit shkurt, komisioni drejtues i vlerësoi angazhimet e të gjitha institucioneve përgjegjëse për raportim, qoftë të institucioneve qendrore dhe vendore, edhe të institucioneve të pavarura, të ministrive të linjës, të njësive të qeverisjes vendore, si dhe të institucioneve të tjera që janë të përcaktuara në planin e veprimit si institucione përgjegjëse të zbatimit të strategjisë dhe të planit të veprimit. Njëkohësisht, vlerësoi përfshirjen proaktive dhe bashkëpunimin e organizatave të shoqërisë civile. Këtu do të më lejoni të shpreh mirënjohjen dhe një falënderim të veçantë për organizatat e shoqërisë civile, të cilat kanë qenë aktive dhe kanë përmbushur një sërë hapësirash të lëna nga institucionet në kuadër të veprimtarive që parashikon plani i veprimit!

Gjithashtu, komisioni drejtues gjatë diskutimit të raportit të parë të progresit lidhur me zbatimin e strategjisë së edukimit ligjor konstatoi edhe disa problematika, të cilat do të doja t'i ndaja me ju.

E para, po e nis me aspektin formal, por që është shumë i rëndësishëm në ecurinë e zbatimit të strategjisë, mosrespektimi i afateve të raportimit nga institucionet përgjegjëse. Pra, një pjesë e institucioneve përgjegjëse nuk kanë raportuar në kohë dhe kjo ka ndikuar drejtpërsëdrejti në hartimin e raporteve të monitorimit nga Ministria e Drejtësisë.

E dyta, cilësia e kontributeve dhe kjo është esenciale. Sikurse ju jeni në dijeni dhe e kemi diskutuar, kontributet duhet të hartohen në përputhje me formatin IPSIS të planit të veprimit. Pa dyshim që kjo ka qenë një vështirësi, prandaj kjo është edhe arsyeja që ne kemi kërkuar ndihmën dhe asistencën e Këshillit të Ministrave, të departamentit të monitoron strategjinë për të ofruar një mundësi trajnimi dhe këshillimi për të gjithë përfaqësuesit e institucioneve që kanë pasur vështirësi për raportimin, sipas këtij formati.

E treta, mosdërgimi i informacionit për disbursimin financiar të veprimtarive të parashikuara nga një pjesë e institucioneve. Ndoshta ky mund të duket një aspekt formal, por strategjia dhe plani i veprimit mund të jetë e shkruar shumë mirë në letër, por nëse nuk ka buxhetin e parashikuar dhe burimet njerëzore të nevojshme dhe të afta për ta kuptuar dhe zbatuar strategjinë dhe planin e veprimit, pa dyshim ai plan veprimi dhe ajo strategji nuk do të kishin vlerë, përveçse do të ishte një strategji në raftin ku janë edhe shumë strategji të tjera. Për këtë arsye, duke vlerësuar rëndësinë që ka buxheti, parashikimi i fondeve edhe për Kuvendin e Shqipërisë, për Komisionin

e Ligjeve dhe për komisionet e tjera, të cilat janë përgjegjëse për diskutimin dhe shqyrtimin e buxheteve do të ishte e nevojshme të dihej nevoja, mundësitë që kanë institucionet, nevojat për rritje të buxhetit ose edhe për koordinuar punën ndërmjet institucioneve për të prodhuar sa më shumë sinergji. Në kuadër të buxheteve më të kufizuara disbursimi financiar për veprimtaritë do të ishte i nevojshëm për t'u raportuar, aq më tepër që është një kërkesë e raportimit që kërkohet për çdo plan veprimi.

Problemi i katërt, të cilin do të doja ta ndaja me ju, është nevoja për një bashkëpunim ndërmjet ministrive të linjës me institucionet e varësisë së tyre kur japin ose shkëmbejnë informacion. Jam e bindur, sikurse edhe kolegët që janë këshilltarë dhe pjesë e stafit të Kuvendit, por kryesisht të sekretariatit të këtij Rrjeti, që ka pasur më shumë aktivitete të zhvilluara nga sa janë raportuar. Fakti që brenda të njëjtave institucioneve institucioni qendror dhe i agjencive të varësisë në një institucion konkret bashkëpunimi nuk ka qenë ai që duhej, pa dyshim që disa ministri kanë dalë me më pak veprimtari të raportuara, ndërkohë që institucione të tjera kanë raportuar më shumë. Unë jam e bindur që për të gjitha rastet kemi pasur më shumë veprimtari.

Të nderuar pjesëmarrës, kolege dhe kolegë, nuk duhet të harroni që ky raport do të shërbejë si një burim edhe për të adresuar nevojat e punës që duhej të bëjnë të gjitha institucionet. Ne flasim për veprimtari të zhvilluara, por njëkohësisht kemi edhe një sërë rekomandimesh nga raportet që përgatisin organizatat e shoqërisë civile, institucionet e pavarura që monitorojnë sektorë të veçantë, qofshin organe në nivel qendror ose në nivel vendor, organet e barazisë, institucione të tjera që raportojnë në Kuvend, ofrim trajnimesh dhe kualifikimesh nga shumë institucione të tjera, siç janë Shkolla e Magjistraturës, Shkolla e Administratës Publike, të cilat po i marr si shembull. Pra, të gjitha këto institucione kanë nevojë të dinë problematikat që kanë dalë dhe ku ka hapësira apo boshllëqe, të cilat duhet të adresohen. Shkëmbimi i informacionit sa më i saktë dhe në kohë është thelbi i zbatimit me sukses i strategjisë së edukimit ligjor të publikut.

Në përfundim të diskutimit komisioni drejtues rekomandoi që në zbatim të vazhdimësisë së zbatimit të strategjisë së edukimit ligjor të publikut dhe të planit të veprimit të ndërmerren disa masa.

Së pari, është sugjeruar të përmirësohet performanca e aktiviteteve të institucioneve që raportojnë, masat dhe aktivitetet në proces zbatimi. Kemi ende aktivitete të planifikuara për vitin 2020, që nuk ishin zbatuar deri në dhjetor të vitit 2020, pra janë në proces zbatimi.

Së dyti, është e nevojshme të ulet numri i masave dhe i veprimtarive që rezultojnë të pazbatuara. Nëse mendoni që veprimtaritë e parashikuara në planin e veprimit nuk janë planifikuar në mënyrë realiste, ekziston mundësia që në kuadër të rishikimit të bëhet një rishikim më i drejtë, korrekt me qëllim që plani të jetë i zbatueshëm dhe rezultatet të jenë të prekshme. Pra, puna ose rezultati i planit të veprimit të mos matet me numrin e aktiviteteve, por me rezultatet që kanë sjellë aktivitetet e kryera.

Së treti, të përmirësohet metodologjia IPSIS e raportimit të zbatimit të masave dhe aktiviteteve për periudhën në zbatim. Përsëri komisioni, por edhe bordi i këshillimit, u treguan të gatshëm dhe udhëzuan, që nëse ishte e domosdoshme për institucionet e caktuara në nivel qendror ose vendor mund të bëhej edhe një trajnim. Ndërkohë, përfaqësuesja e Këshillit të Ministrave u tregua e gatshme në çdo kohë për të asistuar çdo person kontakti në institucionet përkatëse për të marrë udhëzimet e duhura lidhur me raportimin dhe me zbatimin e metodologjisë së raportimit..

Së katërti, kërkohet të vijohet zbatimi i masave në statusin e aktiviteteve ku është shënuar statusi “pjesërisht i zbatuar” ose “në proces” dhe të respektohen afatet që janë parashikuar në planin e veprimit.

Së pesti, është sugjeruar të nisë me kohë zbatimi i masave dhe i kriterëve të parashikuara për periudhën në vijim. Sot, që jemi duke folur, jemi në fund të muajit maj, pra kanë kaluar rreth 5 muaj, unë do t’i ndjek me interes raportimet tuaja, besoj se puna ka vijuar, por duke pasur parasysh përvojën e rrjetit dhe kapacitetet e personave të përfshirë në Rrjet ka mundësi që punët të ecin edhe më mirë dhe plani i veprimit të zbatohet dhe në këtë mënyrë do të kemi rezultate më të mira, më konkrete dhe më të prekshme.

Gjithashtu, është rekomanduar të sigurohen burime dhe kapacitetet njerëzore dhe ekspertiza e nevojshme në kryerjen e veprimtarive. Unë besoj që në çdo institucion apo ministri ka ekspertizë, ka burime njerëzore, mjafton një menaxhim dhe një angazhim më të mirë të tyre dhe do të kishim edhe rezultate më të mira.

Po ashtu, është rekomanduar të sigurohet bashkëpunimi institucional i nevojshëm që për masat dhe aktivitetet, të cilat janë planifikuar të zhvillohen, të jenë të përbashkëta. Prodhimi i sinergjisë “të punojmë së bashku” është me më pak kosto dhe me rezultate më të mira.

Gjithashtu, u rekomandua të garantohet koordinimi i mjaftueshëm për të shkëmbyer në mënyrë të efektshme informacionin dhe për të zgjidhur problemet që kanë penguar zbatimin e

veprimtarive të caktuara, të cilat mund të zgjidhen nga institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me organizatat ose institucionet e tjera që janë bashkëpunëtores.

Për dijeninë tuaj, të nderuara kolege dhe kolegë, raportprogresi për zbatimin e strategjisë së edukimit ligjor është publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, është depozituar pranë Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, i cili është edhe personi drejtues dhe përfaqësues i këtij Rrjeti, si dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Pra, edhe deputetët, edhe Kryetari i Kuvendit, edhe kryetari i Komisionit të Ligjeve, por edhe publiku i gjerë mund ta aksesojë të gjithë raportin, problematikat, rekomandimet dhe nevojën për përmirësime.

Gjithashtu, më lejoni t'ju theksoj, që më 3 mars 2021 është zhvilluar edhe një takim i Bordit Këshillimor të Rrjetit, me rend dite për të diskutuar lidhur me rekomandimet e bordit, mbi metodat për monitorimin më të mirë dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë. Unë mendoj që ka nevojë edhe vetë vlerësimi i zbatimit të strategjisë që të përmirësohet.

Në vazhdim të këtij takimi do të doja të theksoja që anëtarët e bordit dhanë mendime të vlefshme lidhur me punën që duhet bërë, por edhe për fizibilitetin, për të pasur një dukshmëri më të mirë të të gjithë kontributeve që japin institucionet, por edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, por njëkohësisht për ta përdorur këtë raport si burim dhe orientim edhe për donatorët, për të kuptuar se në cilat fusha ka ende nevojë për angazhim më të mirë, ka nevojë për financime, ka nevojë për burime njerëzore, por mbi të gjitha ka nevojë për një shmangie të mbivendosjeve dhe përsëritjeve të veprimtarive, që shpeshherë do të thosha mund shmanget nëse do të kishte një koordinim, bashkërendim dhe raportim më të mirë në kuadër të strategjisë së edukimit ligjor të publikut dhe planit të veprimit.

Ky ishte informacioni që unë do të doja të ndaja me ju. Pika e parë ishte informimi i anëtarëve të rrjetit për çfarë është bërë nga muaji janar deri në ditët e sotme. Nëse do të keni ndonjë pyetje, ndihuni të lirë të adresoni pyetje.

Gjithashtu, ju ftoj të ndajmë informacionin për veprimtaritë që janë zhvilluar gjatë periudhës nga janari dhe deri sot nga institucione, të cilat ju i përfaqësoni.

Për transparencë doja t'ju informoja që zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka paraqitur një raport me shkrim për veprimtaritë që ka zhvilluar janar- maj 2021, në kuadër të objektivit 4/1/1, që është realizmi i materialeve të hartuara, të publikuara dhe të shpërndara qytetarëve dhe institucioneve. Në faqen zyrtare të Komisionerit,

në televizione dhe botime të ndryshme, ka një veprimtari të pasur. Ndërkohë, ne e kemi administruar dhe do të dëshiroja t'ju shpërndahe edhe juve për ta parë këtë veprimtari.

Gjithashtu, Komisioneri ka raportuar edhe për rritjen e kapaciteteve të autoriteteve publike dhe/ose kontrolluese dhe përpunuese në kuadër të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, që është aktivitetit 4/2/1/k, pra në kuadër të së drejtës së informimit, mbrojtjes së të dhënave personale kur ka një veprimtari të gjerë të zhvilluar në kuadër të trajnimeve me autoritetet publike.

Gjithashtu, ka informuar në lidhje zhvillimin e ditëve të hapura për të drejtën e informimit, organizimin e shkollës verore dhe fushatat ndërgjegjësuere në lidhje me lojën: “Thuaj dhe mëso”, veprimtari të zhvilluara me nxënësit e shkollave 9- vjeçare në kuadër të datës 28 janar, që është Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Këto janë disa veprimtaritë e zhvilluara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

I lutem sekretarisë t'i kalojë *online* nëpërmjet postës elektronike tek të gjithë anëtarët, njëkohësisht të informojmë edhe Ministrinë e Drejtësisë, e cila gradualisht të përditësojë informacionin lidhur me planin e veprimit, por edhe për t'u bërë një kujtesë të gjithë anëtarëve nëse konstatojnë vonesa ose probleme në lidhje me zbatimin dhe respektimin e afateve të planit të veprimit.

Faleminderit!

Fjala për ju.

Po, zonja Peka, komisionere nga Avokati i Popullit.

Zonja Peka, nuk dëgjoheni.

A mund të flasë dikush tjetër?

Po, zonja Xhako.

Blerta Xhako – Përshëndetje, zonja Hysi!

Faleminderit!

Ju bëtë një përmbledhje të zbatimit të aktiviteteve që zyra e Komisionerit ka kryer gjatë kësaj periudhe. Ne jua dërguam edhe paraprakisht, megjithatë unë do të ndalem në disa momente kryesore.

Së pari, në disa aktivitete që ne kemi kryer me organizatën romane “Verdi”, me të cilën kemi lidhur një marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të trajnimit të komunitetit rom dhe egjiptian lidhur me legjislacionin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, është duke u zhvilluar dhe organizuar edhe një video, e cila duhet të jetë në funksion dhe në mbështetje të tyre.

Nga ana tjetër, janë zhvilluar trajnime me koordinatorët e aktiviteteve publike lidhur me zbatimin e programit të transparencës, që autoritetet publike duhet të implementojnë me miratimin e programit të ri të transparencës.

Do të doja të veçoja edhe pjesën ku zyra e Komisionerit është në një fushatë në disa qytete të vendit, të cilat unë i kam specifikuar në raportim dhe janë: Pogradeci, Poliçani, Patosi, Ballshi dhe Përrenjasi, ku janë duke u zhvilluar fushata me shkollat 9-vjeçare në këto qytete, pra me nxënësit, që ka në thelb njohjen nga ana e fëmijëve për rreziqet e lundrimit në mjedisin digjital sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, por që është konceptuar në formën e një loje, duke qenë se ata janë nxënës të shkollave 9- vjeçare dhe është sjellë në këtë formë.

Nga ana tjetër, sërish jemi duke monitoruar zbatimin e programit të transparencës si bashkitë e kanë implemntuar, por kjo është shfrytëzuar në formën e bashkëpunimit, që zyra e Komisionerit ka me bashkitë që këto programe të transparencës të implementohen ashtu siç duhet.

Këto janë tri momentet kyçe ku doja të ndalesha. Një informacion më i detajuar ju është dërguar dhe i është bërë prezent rrjetit të sekretariatit.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Zonja Peka, urdhëroni!

Zonja Peka, derisa të siguronit lidhjen, mund ta marrë fjalën dikush tjetër.

Nëse nuk e keni linjën e mirë, ju lutem, lidhuni nga telefonat celularë!

Zonja Peka dhe zoti Keta, ju lutem, rregulloni linjën!

Po, zonja Semini.

Mariana Semini – Përshëndetje!

Kërkoj ndjesë që u bashkova me vonesë, por procesi i provimit në Shkollën e Magjistraturës më mori më shumë kohë se mendova.

Unë, në fakt, desha të ndaja një prezantim, nëse më jepet mundësia ta bëj *share*, në të kundërt po e lexoj.

Shkolla e Magjistraturës është në institucionet...

Vasilka Hysi – Bëje share.

Mariana Semini – Nuk kam mundësi ta bëj share, duhet të më japë *hosti* lejen.

Vasilika Hysi – Ju është dhënë leja.

Mariana Semini – Po vazhdoj se ndoshta ka vështirësi.

Unë doja të eidentoja komponentët që ka Shkolla e Magjistraturës, të cilat janë në planin e veprimit të parashikuara në objektivin specifik 3/1.

Së pari, jemi ndalur në formimin fillestar të kandidatëve për kancelarë, është një grup i kancelarëve në detyrë, atyre ekzistues, i cili është trajnuar, ku janë përfshirë stafet administrative të gjykatave, kancelarët dhe kryetarët e gjykatave, me qëllim që të sensibilizohen për qëllimet dhe objektivat e strategjisë së edukimit të publikut, duke marrë në konsideratë që gjykatat janë vende ku ofrohen shërbime për publikun. Është trajnuar një grup prej 25 personash.

Kemi bërë trajnimet në fushën e programit të trajnimit fillestar, që përfshin jo vetëm kancelarët, por edhe kandidatët për kancelarë. Ky është një proces që ka startuar me hartimi ne kurrikulave, me hartimin e planit mësimor, të cilat, së fundi, në këtë vit akademik janë miratuar edhe nga këshilli drejtues i shkollës. Duke vlerësuar nevojat e këtij grupi, duke u nisur nga grupet ekzistuese të kancelarëve dhe duke parë planifikimet që kanë KLGJ-ja dhe KLP-ja për numrin e kancelarëve të rinj, ne kemi konkluduar, edhe nga pikëpamja e vendimmarrjes administrative, pikërisht miratimin e planit të veprimit, miratimin e planit mësimor të kurrikulave dhe ndërkohë presim që në fillim të vitit akademik 2021-2022 të bëhet edhe seleksionimi i kancelarëve ose i kandidatëve për kancelarë të rinj, që do të hyjnë në programin e trajnimit në shkollë. Këto dy veprimtari janë realizuar me ndihmën e USAID-it dhe me ndihmën e EURALIUS-it, që është në proces, të cilët na ofruan asistencë në përgatitjen e kurrikulave dhe të planit mësimor.

Nga ana tjetër kemi edhe rishikimin e të gjitha kurrikulave, që lidhen edhe me gjyqësorin, e dhe prokurorinë në kuadrin e trajnimit fillestar, ku përfshihen edhe trajnimi fillestar i ndihmësve ligjorë, i këshilltarëve ligjorë, i gjyqtarëve dhe i prokurorëve, pra i magjistratëve, por nga ana tjetër edhe i komponentëve, që lidhen me trajnimin e gjyqtarëve, gjithmonë duke u nisur nga fakti që të gjitha këto grupe janë grupe që ofrojnë një rol të madh aktiv në procesin e edukimit të publikut. Pranë gjykatave dhe prokurorive ofrohen në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike grupe interesi, që vijnë edhe si palë të përfshira në gjykim edhe si palë të përfshira në proces po edhe si palë interesi, që përfitojnë nga shërbimet e tjera të këtyre institucioneve. Kështu që nga Shkolla e Magjistraturës është konsideruar prioritar trajnimi i këtyre grupeve që janë në kontakt me publikun dhe që ofrojnë më të mirën. Duke qenë se trajnimi i tyre, kompletimi i tyre me këto dije rrit cilësinë e shërbimit, nga ne është parë me prioritet miratimi i të gjithë komponentëve që përmenda, vlerësimi i nevojave, plani mësimor dhe kurrikula.

Këto ishin pak a shumë ato që doja të ndaja me ju.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Semini për informacionin!

Më vjen mirë që keni planifikuar trajnimin e kancelarëve dhe kandidatëve për kancelarë, meqenëse janë persona për ndjekjen e të gjitha shërbimeve. Kjo është shumë e rëndësishme. Uroj dhe shpresoj që ky vit të ketë rezultate!

Kam një pyetje: a është bërë një vlerësim i të gjitha faqeve zyrtare të gjykatave në Republikën e Shqipërisë në të tria nivelet, nëse e ofrojnë informacionin dhe nëse janë miqësore për publikun e gjerë, në kuadër të rritjes së aksesit të publikut te drejtësia, por edhe për marrjen e asaj që ne themi, informimit për ndihmën parësore, nëse ju është vënë në dispozicion nga të tjerë, sepse nuk është detyrë e shkollës suaj?

Faleminderit!

Mariana Semini – Në fakt, nuk kemi informacion lidhur me faqet, por në trajnimin e kancelarëve ekzistues në gjykata, një nga komponentët ishte edhe komponenti i IT-së dhe i marrëdhënieve me publikun. Për rrjedhojë ne jemi përpjekur që të rrisim kapacitetet e kancelarëve si lider administrativë të gjykatave dhe prokurorive, me qëllim që ata të organizojnë punën për përgatitjen e këtyre faqeve, por ndërkohë nuk di të them më shumë për gjendjen ekzistuese të faqeve. Mund të them vetëm që ne kemi dhënë rritjen e kapaciteteve nëpërmjet një metode *learnin throë doing*, që të përmirësohet edhe shfaqja në publik e asaj që bëhet aktualisht në gjykata dhe prokurori dhe ofrohet shërbimi sa më afër publikut dhe aksesit të jetë sa më i lartë.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Do ta vlerësonim shumë, zonja Semini, nëse do ta kishim materialin dhe ta ndanim me të gjithë anëtarët e rrjetit.

Dëshironi ta merrni fjalën zoti Keta?

Reald Keta – Ju kërkoj ndjesë që për arsye teknike nuk munda të lidhesha më parë!

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas në nivel strategjik ka parashikuar një seri masash në zbatim të planit për edukimin ligjor.

Së pari, është bashkëpunimi në fushën e ndihmës juridike falas në nivel qendror dhe vendor.

Së dyti, iniciativat e përbashkëta midis OJF-ve; klinikat e ligjit dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas; hartimi i materialeve të fizibilitetit; promovimi i sistemit të ndihmës juridike falas

dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere. Këto janë 5 shtyllat e strategjisë. Përgjatë vitit 2021 prioritet do të jetë funksionaliteti dhe operimi i 10 qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Përgjatë periudhës janar-mars 2021 është bërë e mundur edhe hapja dhe rivitalizimi i 3 qendrave të reja të ndihmës juridike parësore Fier-Vlorë dhe Dibër, kjo falë mbështetjes së UNDP-së.

Tashmë numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me klinikat e ligjit shkon në 10. Marrëveshja e fundit është ajo e muajit shkurt 2021 midis Ministrisë së Drejtësisë dhe përfaqësuesve të universitetit “Marin Barleti”.

Tjetër masë sa i përket ndihmës juridike parësore është hapja e thirrjes për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministria e Drejtësisë. Më pas, sa i përket ndihmës juridike dytësore, është nisja e procesit të kontraktimit të avokatëve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore. Lista është publikuar gjatë periudhës së muajit shkurt dhe është pasqyruar më pas edhe me nënshkrimin e kontratave me avokatët, ku këtë vit numri shënon 124 avokatë të përfshirë në këtë skemë shërbimi.

Për sa i përket cilësisë së shërbimit të ofruar nga ndihma juridike dytësore deri më tani është kryer monitorimi tremujor i 6 qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, më konkretisht bëhet fjalë për Durrësin, Pogradecin, Lezhën, Lushnjën, Shkodrën dhe Tiranën, gjithashtu është planifikuar edhe kryerja e monitorimeve për sa u përket qendrave të tjera.

Në lidhje me aktivitetet ndërgjegjësuere, një temë që edhe ju e ngritët dhe i vendosët theksin, gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar mbi 12 aktivitete ndërgjegjësuere dhe takime ndërmjet aktorëve të sistemit të ndihmës juridike, me fokus promovimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Përmenden këtu qyteti i Elbasanit, i Vlorës, i Lushnjës dhe vazhdohet me Shkodrën, në Pogradec, në Lezhë, në Gjirokastrë, në Dibër dhe në Tiranë për të siguruar një mbulim gjeografik sa më të gjerë.

Për sa i përket forcimit të kapaciteteve dhe trajnimit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore përmendet që është bërë i mundur trajnimi i ofruesve të këtyre ndihmave përmes *ëbëinar*-ve në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera si: Dhoma e Avokatisë, ASPA, apo edhe organizata të tjera si UNDP dhe EURALIUS.

Nuk e di në qoftë se është e nevojshme të ndalem edhe në statistika më konkrete?

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Keta!

Do t'ju lutesha, pavarësisht se jeni pjesë e Ministrisë së Drejtësisë, por besoj për zonjën Janku apo edhe për Kuvendin e Shqipërisë ose për anëtarët e rrjetit të informacionit, të na e sillnit në formë të shkruar, me qëllim që të shpërndahet, por edhe të shërbejë si një dokument për të ditur kush po bën çfarë me qëllim që të prodhojmë sa më shumë sinergji.

Faleminderit!

Zonja Peka, fjala është për ju.

Nela Peka – Faleminderit!

Për sa i përket ushtrimit të mandatit tonë promovues, me fokus edukimin ligjor të publikut, institucioni i Avokatit të Popullit qysh prej janarit dhe deri sot që flasim ka organizuar një sërë veprimtarish të cilësuar “Ditë të hapura”, takime dhe veprimtari të tjera me karakter deklarativ, njoftues, botime të ndryshme e kështu me radhë.

Për sa i përket seksionit që unë drejtoj, për të drejtat e fëmijëve, për çështjen e edukimit ligjor të publikut ne jemi fokusuar në krijimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për një kulturë të re, që do të thotë ndryshim cilësor për sa i përket të drejtave të fëmijëve, të lirisë dhe ushtrimin efektiv të këtyre të drejtave.

Për këtë arsye kemi zhvilluar takime në disa bashki të vendit dhe veçoria është që kësaj radhe kemi tentuar të prekim ato që cilësohen në bazë të ndarjes territoriale administrative si bashki të kategorisë së dytë, ku kemi zhvilluar takime në nivel vendor me strukturat shoqërore jo vetëm për të ushtruar funksionin tonë monitorues, por edhe për t'i ndërgjegjësuar ata për të përmbushur të gjitha detyrat dhe kompetencat, që burojnë si pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor.

Po kështu kemi organizuar edhe inspektime të karakterit monitorues, por edhe proklamues për sa i përket Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, ku kemi inspektuar disa komisariate të vendit dhe kemi hartuar edhe rekomandimet përkatëse për të gjitha gjetjet e adresuara, sikundër kemi qenë edhe në Institucionin e të Miturve në Kavajë, por kësaj radhe, përveç inspektimit në këtë institucion, kemi zhvilluar fokus grup për sa i përket një komponenti shumë të rëndësishëm, për të cilin jemi duke punuar fort, që është vlerësimi i ndikimit për të drejtat e fëmijëve, kryesisht për sa u përket pasojave që COVID-19 ka lënë në përditshmërinë dhe veprimtarinë e tyre të përditshme. Fokus grupi i parë në këtë drejtim ka qenë me të miturit e privuar nga liria në institucionin e vuajtjes së dënimit në Kavajë.

Nuk kemi lënë pas dore edhe “Ditët e hapura” të zhvilluara në disa shkolla të vendit, ku kemi promovuar fort një doracak që kemi botuar për sa i përket edukimit ligjor për të drejtat e njeriut në përgjithësi, por në mënyrë të dedikuar për të drejtat e fëmijëve, sikundër jemi përpjekur të zhvillojmë biseda sa i përket qasjes që vetë fëmijët kanë pasur rreth pandemisë, si janë ndjerë në këtë kohë dhe si e kanë perceptuar veprimtarinë e tyre të përditshme gjatë kësaj periudhe e në vijim.

Jo vetëm seksioni ynë, por edhe seksionet e tjera kanë ushtruar veprimtari të edukimit ligjor të publikut, kjo në themel të mandatit promovues. Për shembull, seksioni i përgjithshëm ka organizuar qoftë nëpërmjet deklaratave publike, organizimit të tryezave të rrumbullakëta, ku fokusi ka qenë barazia gjinore, çështjet e dhunës me bazë gjinore, të drejtat e komunitetit rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuar fokusuar kjo kryesisht edhe sa i përket garantimit të ushtrimit të së drejtës së votës për këtë kategori individësh, duke realizuar disa inspektive në qytete të vendit për të parë më nga afër se sa infrastruktura zgjedhore mundëson pikërisht garantimin e së drejtës së votës për këtë kategori individësh.

Ndërkohë, edhe institucioni i veçantë në institucionin tonë lidhur me promovimin e ndihmës juridike shtetërore falas ka qenë në mënyrë aktive pjesëmarrës në tryeza diskutimesh të organizuara qoftë nga organizatat e OJF-së vendase dhe ato ndërkombëtare, por edhe institucionet shtetërore përgjegjëse siç është Ministria e Drejtësisë, e cila e ka fushë të veprimtarisë së saj shtetërore.

Ndërkohë, që edhe mekanizmi për parandalimin e torturës pikërisht në kuadër të promovimit të rolit të Avokatit të Popullit për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve në pikat e kalimit kufitar së bashku me UNHCR-në edhe partnerë të tjerë, siç është Caritas-i, kanë shpërndarë pamflete pikërisht për të shpjeguar në një gjuhë të thjeshtë rolin, misionin dhe kompetencat kushtetuese dhe ligjore që gëzon Avokati i Popullit për mbrojtjen e kësaj kategorie në vendin tonë.

Pa dashur t’ju marr kohë, veprimtaritë tona promovuese janë në vijim. Ne kemi përgatitur edhe një material dhe ju kërkoj ndjesë, dje në pamundësi për shkak se nuk aksesuam dot *e-mail*-in, do t’ju dërgojmë sot materialin e strukturuar për sa i përket përmbushjes së veprimtarisë sonë si të qenit anëtarë në mekanizmin e strategjisë së edukimit ligjor të publikut.

Ju falënderoj!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Peka, për ekspozenë!

Mirëpresim materialin me shkrim.

Kush dëshiron ta marrë fjalën?

Qendra europiane znj - Përshëndetje, zonja Hysi!

Ju falënderoj për organizimin e takimit, gjithashtu edhe për vëmendjen që i kushtoni strategjisë së edukimit ligjor nga publiku si një akt dhe vazhdimësi që e keni marrë që në krye të herës në diskutimet që ne zhvilluam në Kuvend para miratimit dhe hartimit të kësaj strategjie.

Në kuadër të veprimtarisë së Qendrës Europiane për sa i takon edukimit ligjor të publikut, të drejtave dhe lirive themelore gjatë periudhës që po raportojmë, qendra ka kryer një sërë aktivitete, ku do të përmendja 36 trajnime për rritje kapacitetesh psiko-sociale të të gjithë psikologëve dhe punonjësve socialë që punojnë në sistemin arsimor parauniversitar, aktivitet ky i shoqëruar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë për sa i takon edukimit gjinor dhe barazisë gjinore.

Gjithashtu, janë rritur kapacitetet edhe të Parlamentit të Nxënësve deri tani në 9 qarqe të vendit për të njëjtën temë për edukimin gjinor dhe barazinë gjinore në shoqërinë shqiptare.

Në të njëjtin kuadër, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë një grup ekspertësh janë duke sugjeruar edhe rishikimin e kurrikulës së arsimit të detyrueshëm në disa lëndë të shkencave shoqërore, duke përfshirë aspekte të edukimit gjinor dhe barazisë gjinore në shoqëri, në kuadër të veprimtarive të tjera të zhvilluara nga qendra europiane gjatë periudhës në rekrutim. Ne kemi përfunduar dhe kemi publikuar aplikacionin “Të drejtat e mia” në platformën *Android* dhe shumë shpejt në *IOS*, i cili paraqet një informacion të përgjithshëm për të gjitha të drejtat e grave dhe të vajzave në shoqëri, ndjek programet e punësimit dhe programet, që incentivojnë punësimin e të rinjve të papunë dhe punëkërkesve aktivë në Shqipëri.

Në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, me mekanizmin për parandalimin e torturës së trajtimit çnjerëzor, si edhe me një konsorcium të gjerë ndërkombëtar, është bërë e mundur përgatitja e platformës *e-competence*, formimi i punonjësve dhe stafeve jopolicore për të drejtat e të burgosurve të huaj, që janë në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë kësaj periudhe është duke përfunduar një dokumentar në bashkëpunim me disa organizata të tjera ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe ndikimin e konfliktit të fëmijët, veçanërisht ata që ndjekin sistemin arsimor parauniversitar.

Natyrisht, të gjithë informacionin e përmendur në mënyrë më të detajuar, në kuadër edhe të të gjitha detyrimeve tona, sipas planit të veprimit, do ta dërgojmë me *e-mail*.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit për ekspozenë, por edhe për fushat sensitive dhe të rëndësishme ku jeni fokusuar.

Ju hodhët dritë edhe për një element, që unë do ta bëj si pyetje për të gjithë anëtarët e rrjetit, konkretisht bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të rrjetit, marrëveshjet dhe veprimtaritë e përbashkëta që kanë zhvilluar.

Dëshiron dikush të marrë fjalën?

Mund të bëj unë 2-3 pyetje, që edhe ne të dimë se ku do të fokusohemi në kuadër të rrjetit?

Një nga problemet e konstatuara nga raportimi në fazën e parë ishte se nuk ishin realizuar një pjesë e veprimtarive të parashikuara në vitin 2020, por ishin në proces.

Ju lutem, kur të përcillni informacionin me shkrim, mund të na informoni me një paragraf për veprimtaritë e planifikuara në vitin 2020, të cilat tashmë janë realizuar, ose për veprimtaritë e planifikuara për vitin 2020, por që nuk janë realizuar, arsyet pse nuk janë realizuar dhe nëse keni bërë ndonjë rialokim në kohë të kësaj veprimtarie?

E dyta, meqenëse strategjia ka një pasaportë të indikatorëve, për vitin 2020, por edhe për 6-mujorin e parë të vitit 2021, i cili ende nuk është mbyllur, ka pasur disa veprimtari që duhet të punonin anëtarët e rrjetit.

Konkretisht, unë kam një pyetje, nëse do të mund të përgjigjeni. Tani mundeni, por nëse jo, do t'ju lutesha ta përcillnit informacionin me shkrim.

A është riparë kuadri ligjor në institucionet ku ju punoni, institucionet në nivel qendror dhe vendor, apo në institucionet e pavarura, për të parë nëse ligjet që janë në fuqi e parashikojnë ofrimin e edukimit ligjor të qytetarëve?

Nëse po, a ka pasur ndonjë nismë për rishikimin e këtij komponenti?

Pyetja tjetër ka të bëjë konkretisht edhe me struktura, nëse ka persona të dedikuar, të cilët janë përgjegjës, në institucionet ku ju punoni, për të ofruar elemente, që lidhen me edukimin ligjor të qytetarëve?

Aksesi i qytetarëve të shërbimet e ofruara nga institucionet që ju përfaqësoni është shumë i rëndësishëm. Thelbi i kësaj strategjie është informimi i qytetarëve për shumë nga institutet ose risitë që ka sjellë reforma në drejtësi, por edhe një sërë ligjesh të tjera, dhe për të rritur shërbimin

dhe cilësinë e shërbimit të institucioneve për qytetarët, në mënyrë të veçantë për kategoritë shoqërore që kanë vështirësi.

E treta: a kemi informacion më të detajuar për vështirësitë që mund të kenë hasur strukturat në nivel vendor dhe qendror?

Jo pa qëllim përmenda strukturat në nivel vendor, sepse shumica e shërbimeve dhe e kontaktit të publikut është në organet e qeverisjes vendore dhe me institucionet që veprojnë në nivel vendor.

Në këtë kuadër, do të vlerësoja shumë, dhe nuk e di nëse ka përfaqësues nga shoqatat e bashkive, që të kishim një informacion për hapat e ndërmarrë për krijimin e strukturave, ose, nëse nuk ka mundësi për të pasur një strukturë të dedikuar, të kemi një rishikim të përshkrimeve të punës së personave që informojnë qytetarët.

Jam e bindur se të gjitha institucionet kanë zyrat e marrëdhënieve me publikun dhe personat e dedikuar për të adresuar informacionin dhe për të kordinuar punët për edukimin qytetar në nivel të institucionit që përfaqësojnë. Nëse nuk e kanë, duhet ta kenë.

Gjithashtu, edhe në një mbledhje të mëparshme, ne kemi shprehur një kërkesë dhe interes për rishikimin e kurrikulave në Ministrinë e Arsimit.

Shpesh, ngjarjet që kanë ndodhur kohët e fundit, por edhe vështirësitë që hasin kategori të caktuara shoqërore, nuk flas vetëm për komunitetin rom, egjiptian, LGBTI, por edhe për persona, që vijnë nga familje me probleme ekonomike dhe sociale, për shumë qytetarë që jetojnë jashtë qendrave ku ka një përqendrim të institucioneve dhe një veprimtari të shoqërisë civile, tregojnë se ka nevojë për përmirësim të kurrikulës, ka nevojë për një qasje tjetër që në sistemin parashkollor.

Do ta vlerësonim shumë që Ministria e Arsimit ta paraqesë më të detajuar raportin pranë Ministrisë së Drejtësisë për shumë nga detyrat që ka në kuadër të strategjisë dhe planit të veprimit, por, nga ana tjetër, kjo është shumë e domosdoshme edhe për të orientuar kontributin dhe sinergjitë që mund të prodhojnë institucionet e tjera, por, në mënyrë të veçantë, roli i jashtëzakonshëm dhe mundësitë që ka shoqëria civile, qoftë për ekspertizën, apo edhe për burimet njerëzore dhe financiare.

Gjithashtu, në kuadër të planit të veprimit, është kërkuar dhe një nga indikatorët ka qenë që, të paktën, duhet të kishin 3 marrëveshje të nënshkruara të bashkëpunimit ndërinstitutional.

Do ta vlerësonim shumë nëse në raportin që do t'i përcillet Ministrisë së Drejtësisë të kishim edhe një informacion nëse ka marrëveshje të nënshkruara.

Në dijeninë time, Drejtoria e Ndihmës Juridike ka nënshkruar marrëveshje me klinika, me universitete dhe me shoqëritë civile, pasi këto janë edhe pjesë e ligjit “Për ndihmën juridike” të garantuar nga shteti, por nëse ka bashkëpunime ose marrëveshje të nënshkruara edhe midis institucioneve të tjera, me aktorë të shoqërive civile, apo mes institucioneve të dedikuara enkas në fushën e edukimit, informimit dhe sensibilizimit të publikut, do ta vlerësoja shumë dhe do të ishte e dobishme për të pasur një raport më cilësor, me tregues konkret, që të mos ketë vetëm fjalë të përgjithshme apo aktivitete që janë pjesë rutinë e veprimtarisë së një institucioni ose një organizate, por të jenë të dedikuara edhe në kuadër të detyrimeve, që burojnë nga plani i veprimit.

Po ashtu, unë kam konstatuar, flas në cilësi personale, se shumë nga veprimtaritë e institucioneve, por edhe organizatave të shoqërive civile, nuk njihen sa dhe si duhet nga publiku, por, mbi të gjitha, nga grupet e interesit, nga personat që duhet të marrin shërbime.

Mendoj se do të ishte me shumë interes të diskutohet, dhe ky ka qenë edhe një diskutim me bordin këshillimor, por edhe me komisionin drejtues, se si mund të bëhet më i dukshëm, si mund të shkojë ky informacion te njerëzit, që janë në nevojë, te personat që nuk ndjekin arsim, që nuk kanë kulturën e nevojshme juridike, por kanë nevojë për të marrë shërbime, dhe shumë prej tyre, sot që ne flasim, nuk e dinë se si ta kërkojnë shërbimin, ku ta marrin shërbimin, nuk i njohin shumë nga institucionet ose institutet e reja, që janë krijuar edhe në kuadër të të gjithë paketës së ligjeve që kemi kaluar në kuadër të reformës në drejtësi, por edhe të shumë ligjeve të tjera të miratuara, të cilat rregullojnë shërbimet për qytetarët.

Në këtë kuadër, do ta vlerësonim shumë të kishim një informacion të detajuar, që t’i shkojë Ministrisë së Drejtësisë, meqenëse do të përgatitet brenda muajit qershor edhe raporti i 6-mujorit për veprimtarinë, ku të përfshihen detyrimisht të gjitha veprimtaritë e vitit 2020, të cilat nuk janë plotësuar brenda kohe, ose ishin në proces zbatimi, por mos harroni, edhe të gjitha veprimtaritë nga janari deri në periudhën që do të raportohet.

E fundit, do të doja mendimet dhe sugjerimet e anëtarëve të rrjetit se si mund të kemi një raportim më cilësor; mbi të gjitha nuk është raportimi, sepse ai është instrument për të monitoruar përmbushjen e detyrave se sa jemi ne në shërbim të qytetarëve, sa i informojmë ata, sa ua lehtësojmë jetën, barrën dhe kostot për të marrë një informacion, por, mbi të gjitha, janë ecejaket nëpër dyert e institucioneve të gabuara për shkak të mungesës së informacionit.

Në këtë kuadër, do ta vlerësonim shumë fokusin te disa kategori që ne i kemi të veçanta, pakicat, minoritetet, të gjitha llojet e minoriteteve, komunitetin rom, egjiptian, LGBTI, të miturit

dhe jetimët. Të mos harrojmë se kemi kategorinë e grave kryefamiljare, kemi gratë, adresimin e problemeve të diskriminimit gjinor.

Nga ana tjetër, të mos harrojmë se nga momenti i miratimit të strategjisë janë miratuar shumë ndryshime në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ose në ligje të tjera që, në dijeninë time, nga informacioni që kemi ne si Kuvend, shumë nga institucionet mund ta dinë, por grupet e interesit, qytetarët, që duhet të përfitojnë nga shërbimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk janë në dijeni.

Në këtë kuadër, të nderuar kolegë dhe kolege, po flasim si mbrojtës së të drejtave të njeriut, veprimtarë të të drejtave të njeriut, do të doja t’ju inkurajoja të punojmë fort për të shkuar aty ku janë njerëzit në nevojë.

E vlerësoj fakti që Drejtoria e Ndihmës Ligjore falas, Avokati i Popullit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit po punojnë në bashkitë e nivelit të dytë. Pra, kemi dalë nga Tirana, nga kryeqyteti, ku ka qenë fokusi dhe përqendrimi më i madh i veprimtarive, duke shkuar drejt bashkive të vogla, madje duhet të shkojmë drejt zonave rurale, pasi në kuadër të reformës territoriale administrative, përgjegjësitë e bashkive janë më të mëdha, por aksesit dhe shërbimet duhet të shkojnë deri te qytetari që jeton në skajin më të largët të njësisë territoriale administrative.

Unë do t’ju lutesha, edhe si sugjerim në emër të Kuvendit të Shqipërisë, të rrjetit që drejtoj, për të pasur një qasje të kategoritë shoqërore dhe në zonat ku jemi më deficitar.

Do t’i vlerësoja shumë të kishit sugjerime për parlamentin e ri, që ka dalë nga 25 prilli. Çfarë do të sugjeroni ju në kuadër të detyrave dhe përgjegjësisë që kanë pikërisht përfaqësuesit e zgjedhësve, deputetët dhe deputetët e reja, të cilët do të marrin detyrën më 9 shtator, për të punuar në zonat e tyre, për të përfaqësuar dhe shpërndarë të gjithë informacionin, pasi është detyrë në bazë të ligjit të statusit të deputetit, që ne deputetët kemi përgjegjësi për të adresuar informacion, për të asistuar zgjidhjen e ankesave që mund të kenë zgjedhësit, pavarësisht nëse e kanë votuar ose jo deputetin apo deputeten.

Këto ishin disa nga sugjerimet dhe shqetësimet tona, si drejtues të rrjetit në kuadër të strategjisë. Nuk e di nëse përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë ose të Këshillit të Ministrave kanë diçka për të thënë në mbyllje të këtij takimi.

Po, zonja Xhako.

Blerta Xhako – Për t’iu rikthyer edhe një herë pyetjes që ju drejtuat në lidhje me parashikimet ligjore, Zyra e Komisionerit aktualisht është në proces të përafrimit të legjislacionit

për mbrojtjen e të dhënave personale me GDPR-në, pra me Rregulloren Europiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe me direktivën e policisë. Njëkohësisht, duke qenë se kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit janë të përcaktuara në këtë ligj, po shikohet paralelisht edhe ndryshimi i ligjit për të drejtën e informimit. Në këtë kuadër, duke qenë se do të bëhen këto ndryshime, kemi parë nevojat ose ndryshimet e tjera që kanë lindur gjatë zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, ku është parashikuar të shtohet një pikë në një dispozitë të caktuar të ligjit lidhur me garantimin e të drejtës për informacion në përputhje me të gjitha rregullimet ligjore të personave me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër, edhe garantimin e informacionit falas për të gjithë ata qytetarë që janë pjesë e skemës së ndihmës juridike, duke e parë në përputhje me këtë legjislacion. Sigurisht, ligji do të jetë në proces konsultimi dhe aktualisht është në proces hartimi nga Zyra e Komisionerit, kështu që do ta ndajmë. Megjithatë, doja ta anticipoja këtë informacion, duke qenë se u prek nga ju shkurtimisht.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Xhako!

Më vjen mirë që e parapritë, pasi nga gjithë leximi i raporteve që ne kemi bërë, kemi konstatuar se ka nevojë për një qasje më të mirë për kategori të caktuara, qoftë për personat që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë, qoftë për persona të tjerë me nevoja të veçanta apo për atë kategori të qytetarëve, të cilët kanë nevojë për një asistencë për edukim ligjor falas. Për më tepër, periudha e pandemisë nxori në pah një sërë problematikash për një kategori të caktuar të shoqërisë, për të cilët ka nevojë për një reflektim më të mirë. Unë mendoj se i kemi të gjitha kapacitetet, mundësitë dhe burimet njerëzore për të bërë një riorganizim dhe organizim më të mirë të punës për t'i ofruar shërbim kujtdo pa diskriminim, në mënyrë që të gjithë të ndihen të barabartë.

Nuk e di nëse zonja Qaja ka diçka për të thënë në mbyllje, pasi do të fillojmë një mbledhje tjetër. Më pas fjala për zonjën Elona.

Evis Qaja – Zonja Hysi, po ia lë fjalën Ministrisë së Drejtësisë dhe më pas po e marr unë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Dakord, faleminderit!

Elona Hoxha – Përshëndetje, zonja Hysi!

Përshëndetje, kolegë!

Ju falënderoj për mbledhjen e sotme!

Në konkluzion të gjithë takimit dhe ndarjes së ecurisë së çdo institucioni në realizimin e masave të veta, në zbatim të edukimit ligjor për publikun, Ministria e Drejtësisë në përmbushje të detyrave funksionale për hartimin e raporteve 6-mujore dhe vjetore do të mbetet në pritje që gjatë muajit qershor të hartojë informacionin narrativ për çdo institucion për kontributin e tyre për zbatimin e këtyre masave. Në përfundim të periudhës 6-mujore, sikurse vepruam edhe në fund të vitit 2020, do të vijmë me një kërkesë elektronike dhe zyrtare për hartimin e raportit sipas sistemit IPSIS. Ne, si përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, do t'ju luteshim që kjo kërkesë të dalë nga rrjeti sot, të miratohet dhe të konkludohet nga të gjithë ne bashkërisht për të mos hasur si herën e kaluar probleme në vonesa në raportim apo në cilësinë e raportimit.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

E para, unë nuk e di nëse kërkesa do të dalë sot, por të paktën deri nesër, pasi ne kemi disa mbledhje të tjera, ndërkohë që do të fillojmë.

E dyta, do të jetë një kërkesë e detajuar, duke pasur parasysh raportimin jo më narrativ, por sipas indikatorëve që ka plani i veprimit, lista e aktiviteteve, shkalla e realizimit, buxheti, problematikat që kanë dalë, veprimtaritë në proces, pra të marrim tashmë një përgjigje më konkrete për çdo tregues, me qëllim që edhe Kuvendi të jetë në gjendje të vlerësojë jo thjesht sa aktivitete kemi bërë, por rezultatet e këtyre aktiviteteve. Pra, të nisemi nga produkti dhe jo nga thjesht aktiviteti i kryer.

Po, zonja Qaja.

Evis Qaja – Të falënderoj, zonja Hysi!

Falënderoj kolegët, anëtarë të rrjetit!

Këto mbledhje, në fakt, janë shumë të vlefshme në kuadër edhe të mobilizimit, por edhe të njohurisë midis nesh si anëtarë për të kuptuar se si kanë ecur masat prioritare në kuadër të reformës, nëse do ta quaja kështu, të edukimit ligjor, pasi është një nga komponentët kryesorë për sa i takon impaktit të drejtpërdrejtë dhe rezultateve të qytetarët që me shumë të drejtë ju, zonja Hysi, i përmendët edhe në aspektin e rezultateve në kuptimin e targetgrupeve të fokusuar, sigurisht, kundrejt përtej periferisë në aspektin e ndihmës ligjore, por edhe edukimit për njohjen e tyre që në shumë aspekte plani në mënyrë shumë gjithëpërfshirëse i ka përfshirë.

Ajo që doja të theksoja në përfundim të këtij takimi shumë të vlefshëm, por edhe në kuadër të informimit lidhur me aspekte të caktuara që institucionet kanë ndërmarrë për këtë periudhë 5-

mujore për vitin 2021, por edhe masat që kanë qenë pjesë e detyrimeve për zbatim për vitin e kaluar, është se unë mbështes kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë për respektimin e afateve, të cilat, në fakt, ndikojnë edhe në kuadër të monitorimit për sa i takon cilësisë së të dhënave. Këtu nuk flasim për çështjet e formateve, pra për çështjet strukturore, por flasim për përmbajtjen dhe cilësinë e të dhënave kundrejt rezultateve. Sistemi IPSIS, në fakt, nuk ka të bëjë me pjesën strukturore se si do të formatohet një raport, por është ajo që ju e theksuat me shumë të drejtë, zonja Hysi, që këto strategji të mos mbeten në raftet e një biblioteke të caktuar, por të jenë operacionale kundrejt rezultateve, kundrejt treguesve të performancës. Në fakt, sistemi IPSIS dhe mënyra e raportimit dhe monitorimit garanton këtë cilësi të të dhënave, këtë cilësi kundrejt rezultateve, jo kundrejt zbatueshmërisë së aktiviteteve rutinë që një institucion apo disa institucione kryejnë në përditshmërinë e tyre. Kështu që jam e sigurt se edhe Ministria e Drejtësisë tashmë ka kapacitete më të thelluara kundrejt koordinimit dhe validimit të të dhënave kundrejt institucioneve. Nëse, sigurisht, përgjatë kësaj periudhe raportimi do të këtë nevoja të dedikuara për institucionet, të cilat janë pjesë e zbatueshmërisë së planit të veprimit, absolutisht si radhën e kaluar ne jemi të gatshëm për të bashkëpunuar, për të ndihmuar, për të asistuar, për të suportuar ministrinë, por edhe anëtarët e rrjetit kundrejt të dhënave sipas qasjes sistemike. Kështu që në këtë aspekt është shumë e rëndësishme cilësia.

Së dyti, ajo që do të doja të theksoja ka të bëjë edhe me pjesën e afateve të raportimit. Nëse kjo periudhë e ciklit që do të raportohet ka të bëjë me periudhën 6-mujore, do të thotë se ministria jo vetëm që do të garantojë më herët, por edhe institucionet vetë në këtë rast. A ka mundësi Ministria e Drejtësisë si koordinues të afektojë nëse ky raport 6-mujor mund të realizohet nga institucionet deri në datën e fundit të periudhës 6-mujore? Këtu flas nga pikëpamja teknike dhe Ministria e Drejtësisë dhe institucionet jam e sigurt që më kuptojmë. Kështu që, në këtë aspekt, unë do të doja të merrej si mendim, qoftë tani apo përmes një *email*-it për mënyrën se si do të operohet për këtë rast për shkak të specifikimeve që ka mbyllja e parlamentit në korrik për t'i hapur një cikël të ri jetës parlamentare për periudhën e shtatorit.

Këto duhen marrë në konsideratë kryesisht, sepse afektojnë cilësinë e raportimit, afatet, por edhe brendësinë për analizën e performancës dhe rezultateve që ka kryer çdo institucion. Unë do të inkurajoja fort Ministrinë e Drejtësisë, e cila ka në këtë rast barrën për të koordinuar cilësinë, por edhe për të garantuar marrjen e të dhënave nga të gjitha institucionet për të mos lejuar hendek, ashtu siç ju me të drejtë e theksuat në problematikat e fillimit të mbledhjes, të cilat kishin

institucionet që nuk mundën dot të raportnin për shkaqe të ndryshme. Për t'i eliminuar të gjitha risqet do të sugjeroja që të merren të gjitha masat, kryesisht nga Ministria e Drejtësisë, për të garantuar raportim në kohë, por edhe raportim me cilësi për të përmirësuar nga cikli i parë i vitit 2020.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Qaja!

Unë shqetësimin e Ministrisë së Drejtësisë e mora në konsideratë. Ne nesër do të nxjerrim një shkresë, ku do të tërheqim vëmendjen, njëkohësisht, unë do të vë në dijeni edhe Kryetarin e Kuvendit, se tani është periudha që po raportojnë edhe institucionet e pavarura në Kuvend, është periudha që po raportojnë nëpër komisione, por do të raportojnë edhe në seancën plenare. Ne nesër kemi katër institucione që do të raportojë dhe mundësia për t'iu adresuar, edhe pyetje, duke pasur edhe ministra të pranishëm dhe mund t'i nxisim edhe më mirë, pra mund të përdorim të gjitha instrumentet e kontrollit parlamentar. Nga ana tjetër, unë do të kisha një sugjerim, në varësi të asaj që ju thatë, ndoshta edhe Ministria e Drejtësisë mund ta vlerësojë: meqenëse parlamenti shpërndahet në datën 8 korrik (pra ne nuk mund të kalojmë ligje, por parlamenti aktual do të shpërndahet më 8 shtator) dhe deri në datën 8 korrik ne mund të kemi miratim ligjesh, rishikime, ligje të reja e me radhë, ndaj unë do të vlerësoja që të kishim një raport në fund të qershorit, pasi nuk besoj se të gjitha institucionet kanë lënë për t'i bërë veprimtaritë në javën e tretë dhe të katërt të qershorit. Për shembull, po të marrim Ministrinë e Arsimit ajo do të jetë në sezon provimesh dhe çfarë ka pasur për t'i kryer, i ka kryer. Nga sa kuptoj, disa ministri kanë peshën më të madhe në raportim edhe në kuadër të indikatorëve që unë pashë.

E dyta, do të kërkoja një qëndrim më proaktiv nga Ministria e Drejtësisë dhe pajtohem me atë që thatë ju, zonja Qaja, që jo thjesht duke i bërë një shkresë, se, po të ishte vetëm për një shkresë, nuk do të kishim pasur raporte sot, por duke kontaktuar, duke folur dhe duke asistuar. Edhe ne në Kuvend e kemi kaluar atë pjesë të protokollit të komunikimit *online*, pra kemi përdorur të gjitha metodat e ligjshme që lejon dhe mundëson komunikimi në realitetin shqiptar.

E treta, unë do të doja t'ju vija në dijeni, të nderuar përfaqësues që jeni të pranishëm, se pjesa më e madhe e strategjive ka mbaruar. Pra, afati i strategjive dhe plani i veprimit të strategjive të ndryshme është në përfundim. Nëse jeni pjesë e konsultimit, dhe besoj se jeni pjesë e konsultimit publik të strategjive që po përgatiten në fusha të ndryshme, do t'ju inkurajoja fort për t'i dhënë tonin e duhur dhe për të ndërlidhur Strategjinë e Edukimit Ligjor me strategjitë e tjera që po

përgatiten, qoftë strategjinë për integrimin, për romët apo strategjitë në fushën e shëndetësisë, për axhendën e fëmijëve e të tjera. Pra, të kemi një ndërlidhje gjithmonë në aspektin e edukimit ligjor dhe të informimit të qytetarëve. Kemi ligje të mira, por qytetarët nuk i njohin ende mirë. Prandaj, ka shumë nevojë për të punuar konkretisht, jo për të thënë sa aktivitete bëhen, por nga këto aktivitete sa qytetarë janë më pak të dobët, më pak të viktimizuar për shkak të mosnjohjes së ligjeve.

Më lejoni ta mbyll takimin dhe t'ju falënderoj edhe një herë!

Do t'ju lutesha shumë ta dërgoni informacionin me shkrim për ta ndarë midis anëtarëve të rrjetit. Njëkohësisht, nesër të gjithë anëtarë të rrjetit të pranishëm ose jo të pranishëm do të marrin një shkresë, një komunikim zyrtar nga ana e Kuvendit dhe ndihuni të lirë të na adresoni me shkrim mendimet dhe sugjerimet tuaja se si mund ta përmirësojmë zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit.

Shumë faleminderit!

Ju uroj një ditë sa më të mbarë!

Mbyllet mbledhja.